

Date Printed: 04/21/2009

JTS Box Number: IFES_65
Tab Number: 84
Document Title: Qeverisja Komunale
Document Date: 2000
Document Country: Kosovo
Document Language: Serbian/Bosnian
IFES ID: CE00928



* F A D 9 0 5 1 3 - 1 C C A - 4 7 3 C - 8 9 B 3 - 0 1 8 D 6 E E 2 3 6 D 3 *

Qeverisja Komunale

Për herë të parë, më 28 tetor të vitit 2000, nën udhëheqjen e Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-ut), nëse jeni të regjistruar, ju do të mund të zgjedhni përfaqësuesit në Kuvendet të cilat do t'i udhëheqin 30 komunitat e Kosovës.

Qeveria e nivelit komunal i qaset jetës së përditshme të secilit qytetar. Përgjegjësitë e shumta të kuvendit komunal e përfshijnë edukimin parashkollor, fillor, të mesëm, përkujdesjen primare shëndetësore, shërbimet sociale dhe vendosjen, mbrojtjen e ambientit të vendit, sigurimin e shërbimeve komunale dhe infrastrukturës siq janë uji, mbeturinat, kanalizimi, transporti i qytetit dhe ngrohja, si dhe shërbimet publike siq është shërbimi i emergjencës dhe i zjarrëfikësve.

Qeveria e nivelit komunal i qaset jetës së përditshme të secilit qytetar.

Kuvendi komunal, i zgjedhur drejtpërdrejtë nga ju, është organi kryesor qeverisës i komunës. Ai e miraton statutin i cili themelon mënyrën se si do të realizohen përgjegjësitë e tij. Ai do të mund të nxjerrë rregulloret komunale lokale të cilat do të kenë fuqinë e ligjit. Kuvendet do të kenë mes 17 dhe 51 anëtarë, varësisht nga numri i popullatës së komunës. Mandati i parë për anëtarët do të jetë dy vite.

Por pjesëmarrja në demokracinë e vendit do të thotë më shumë se vetëm hudhja e votës në ditën e votimit.

Anëtarët e kuvendit e zgjedhin nga rradhët e tyre kryetarin, i cili do të ushtrojë detyrën e kryesuesit politik të komunës. Kuvendi e cakton Zyrтарin

Kryesor Ekzekutiv si dhe Bordin e Udhëheqësve. Kryetari dhe Zyrтарi Kryesor Ekzekutiv e mbikqyrin përmbushjen e vendimeve të kuvendit nga ana e shërbimit civil komunal, që është një organizatë profesionale jo

politike, e emëruar në bazë të kualifikimeve. Anëtarët e zgjedhur nuk kanë të drejtë të mbajnë pozita të larta në shërbimin civil komunal.

Ata janë gjithashtu përgjegjës për administrimin e financave të komunës. UNMIK-u i ndan fondet për komuna nga Bugjeti i Konsoliduar i Kosovës, pas vlerësimit të nevojave financiare

dhe burimeve të secilës komunë. Komuna gjithashtu mund të pranojë edhe të ardhura të tjera nga taksat dhe dënimet të ardhura nga pronat komunale dhe gjokat. Bugjeti Komunal i bazuar në këto fonde duhet të përmbajë një plan të aktiviteteve dhe

menagjimentit ekonomik gjatë vitit fiskal, që do të jetë i pregaditur në

mënyrë transparente dhe objektive para se të miratohet nga kuvendi.

Komunat nuk do të punojnë të izoluar por ato do të mbikëqyrjen nga nivelet më të larta të qeverisë, në këtë rast UNMIK-ut.

Administratori komunal i

UNMIK-ut,
përfaqësuesi i

Përfaqësuesit Special të
Sekretarit të

Përgjithshëm në secilën
komunë, do të jetë

përgjegjës për kalimin
progresiv të pushtetit

nga trupat e mëparshëm
të qeverisë në kuvendin

komunal të zgjedhur
rishtas. Prej atëherë, ai

do të vazhdojë të punojë me

qeverinë komunale, duke i

koordinuar aktivitetet e UNMIK-ut

dhe të komunës, në lëminë e

rindërtimit, pajtimit, dhe zhvillimit
ekonomik.

Administratori

komunal gjithashtu do
të mbikëqyrë punën e

kuvendit komunal dhe
mund të ndërhyjë për

të siguruar që vendimet
e tij janë në pajtim

me mandatin e

UNMIK-ut, me

Rezolutën 1244 të

Këshillit të Sigurimit,

dhe që ato t'i

respektojnë të drejtat

dhe interesat e

bashkësive të pakicave

kombëtare në komunë.

Në këto rrethana,

vendimet e komunës i

drejtohen Përfaqësuesit

Special të Sekretarit të

Përgjithshëm, i cili mund t'i

anulojë ato apo madje mund edhe të
anulojë edhe kuvendin dhe të kërkojë
zgjedhje të reja.

Kuvendi komunal është zgjedhur
për t'i përfaqësuar të gjithë banorët
e komunës. Votimi në zgjedhjet

komunale është mënyra më e

drejtpërdrejtë dhe më

efektive për ju që të

siguroheni se qëndrimet,

interesat dhe pikëpamjet

e juaja lidhur me qështjet

e vendit janë të

përfaqësuar. Por

pjesëmarrja në

demokracinë e vendit do

të thotë më shumë se

vetëm huda e votës

në ditën e votimit.

Kuvendet e reja qëndrojnë për t'u

shërbyer të gjithë banorët në

komunë. Për t'u siguruar se ato

e bëjnë atë, ju duhet t'i mbani

përgjegjës përfaqësuesit tuaj.

Procedurat e qeverisë komunale do

t'u lejojnë ju që pandërprerë të

kontrolloni aktivitetet e

përfaqësuesve tuaj. Çdo

sesion dhe dokument

i kuvendit zakonisht

është i hapur për

publikun dhe shtypin.

Aq më shumë, do të

mbahen takime të

hapura gjatë vitit, ku ju

do të mund t'u bëni

pyetje të drejtpërdrejta

përfaqësuesve tuaj. Dhe

përfundimisht, nëse ju

mbetni të pakënaqur me

punën e përfaqësuesve

tuaj, ju mund të futni

në përdorim mjetin më

të fuqishëm tuaj — që

me anë të votës t'i

shkarkoni ata nga funksioni në

zgjedhjet e ardhshme që do të

mbahen pas dy vitesh.

**Që qeveria
komunale të
funksionojë, ju
duhet t'i mbani
përgjegjës
përfaqësuesit
tuaj.**

**Votimi në zgjedhjet
komunale është
mënyra më e
drejtpërdrejtë dhe
më efektive për ju
që të sigurohen se
qëndrimet,
interesat dhe
pikëpamjet e tyre
lidhur me qështjet
e vendit janë të
përfaqësuar.**

OSCE
MISSION IN KOSOVO

UNMIK